



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 19 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Halit Krasniqi, Haki Demolli dhe Amir Ahmeti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Artan Canhasi – EULEX, Natyra Kasumaj – KDI, Selman Soboli – student (UP), Lumniye Murati- ZPRK, Skënder Shabani – student, Fatos Qerimi – student, Sylë Ahmeti – Kosova sot, Edon Myftari - këshilltar ligjor – NDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.12.2011;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.12.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12. 12. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente dhe hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Albulena Haxhiu - Theksoi se në Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, përveç tjerash, parashihen edhe 2 nene, e që për ne si lëvizje janë të dëmshme dhe të papranueshme. Ajo që ka të bëjë me privatizimin nuk është paraparë në këto amendamente, mirëpo vetëm njëri që ka të bëjë me decentralizimin, i cili parasheh krijimin e komunave në bazë të Pakos së Ahtisaarit, e që ne jemi kundër krijimit të komunave mbi baza etnike. Po ashtu, kam vërejte edhe te amendamenti 4, është problematik, sepse parasheh heqjen e së drejtës së shujtave për shërbyesit civilë, e që nuk e di a e ka këtë të drejtë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Për këtë arsye unë do të votoj kundër këtij Projektligji.

Ardian Gjini - Tha se grupi parlamentar i AAK-së nuk do ta votojë në seancë këtë Projektligj, mirëpo në Komision e kemi vetëm një mjet: harmonizimin e amendamenteve me Kushtetutën dhe ligjin, prandaj në këtë aspekt nuk kam vërejte.

Arsim Bajrami - U pajtua me parafolësin, sepse si Komision kryesor e shikojmë vetëm bazueshmërinë në Kushtetutë dhe Komisioni FunkSIONAL është marrë me amendamentimin e Projektligjit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 4 vota për, 2 vota kundër dhe 1 abstenim, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mufera Şinik, hyri me vonesë në mbledhje dhe nuk mori pjesë në votim.

4. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi